



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3099/7 prot.

Datë 11.12.2025

V E N D I M

Nr.1837/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Alb Garden” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Alb Garden” SHPK me NIPT K37513520N dhe adresë: Lagjja "Skenderbeg", godine

private 1 katëshe në superstradën Lezhe - Shkodër, km 1.

Operatori ekonomik “Rej” SHPK, me NIPT J93711608Q dhe adresë: Rruga Dritan Hoxha, ngjitur me Shkollën Ahmet Gashi, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, Hyrja 3, Apartament, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekte të interesuara:

Operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK me NIPT M01927023H dhe adresë: Rruga Koke Malci, nr pasurie 4/49/ND Burrel,Mat.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje

me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.5. Operatorët ekonomik ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 13.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 16.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Rej	19,482,000	lekë	Skualifikuar
Asi Invest	21,510,000	lekë	Kualifikuar
Alb Garden	22,278,000	lekë	Kualifikuar
Cara	25,500,000	lekë	Skualifikuar
BOE Agro - Korani shpk & Kurora	25,608,000	lekë	Kualifikuar
Gjelbërimi 2000	26,252,850	lekë	Skualifikuar
Pastrime Silvio	30,634,500	lekë	Kualifikuar
Clean Fast	30,785,382	lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 23.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 31.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6027 si dhe nr. Protokolli 3099/2025 datë 31.10.2025 i operatorit ekonomik “AlbGarden” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

II.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3099/1 prot., datë 03.11.2025.

II.5.2. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.2811/10 prot., datë 11.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3099/2 prot., datë 12.11, ka përcjellë pranë KPP vendimin e KSHA nr.129/2025, datë 11.11.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...]Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues "AlbGarden" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik "ASI INVEST" shpk me arsyen se "3. Së treti oferta e shoqërisë ASI INVEST shpk., nuk plotëson kriterin lidhur me mjetet dhe pajisjet e kërkuara. [...]nuk e përmbush kriterin e kërkuar në pikën 2.3.5 të dst lidhur me: a) mjetin për vaditjen e sipërfaqeve të gjelbërta (autobot) [...]", KSHA vëren se:.... shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori ekonomik "ASI INVEST" shpk në sistemin e prokurimit elektronik si dhe atij të dorëzuar në formë shkresore në formatin hard copy pranë Autoritetit Kontraktor, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se në përmbushje të DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5, OE nëpërmjet Shtojcës 10, Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar se disponon 1 (një) Mjet per vaditjen e sipërfaqeve të gjelberta (Autobot) me targa AA 687 DR.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit provues, KSHA konstaton se në dokumentin e paraqitur Leje qarkullimi për mejtin me targa AA 687 DR, në pikën [J.1]-Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton se mjeti i deklaruar është "Për Transport Mallrash të Rrezikshme", ndërsa në pikën 4. -"Lloji i mjetit" përcaktohet "Automjet për Transport të Veçantë".

Pra, automjeti i deklaruar nga OE "ASI INVEST" shpk si mjet për vaditjen e sipërfaqeve të gjelberta (Autobot) është i rregjistruar/liçensuar dhe i destinuar për transport mallrash të rrezikshme.

Referuar Ligjit Nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme", në Nenin 4, pika 17, përkufizohet se: "Mallra të rrezikshme" janë ato substanca ose artikuj, transporti me rrugë ose me hekurudhë i të cilëve është i ndaluar ose i autorizuar vetëm në rrethana të caktuara nga ADR-ja ose RID-i".

Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar në formë shkresore hard copy pranë Autoritetit Kontraktor, KSHA vëren se automjeti me targa AA 687 DR, i deklaruar nga OE "ASI INVEST" shpk si mjet për vaditjen e sipërfaqeve të gjelberta (Autobot), është shoqëruar me stemën me numrin 33/1202. Sipas Marrëveshjes ADR rezulton se tabela 33/1202 është shenja identifikuese e rrezikut, e cila është e detyrueshme për çdo mjet që transporton mallra të rrezikshme.

Numri i pare (33) tregon shkallën e rrezikshmërisë, ndërsa numri i dytë (1203) është numri identifikues i substancës sipas Kombeve të Bashkuara (UN number), që në rastin konkret korrespondon me Benzinë (Gasolinë, Petrol) sipas listës zyrtare të mallrave të rrezikshme në ADR dhe rekomandimet e UN.

KSHA gjykon se, një mjet, i cili në Leje qarkullimi rezulton çisternë për karburant nuk mund të përdoret për transport uji për vaditje, pasi ai është projektuar në origjinë për transport substancash të rrezikshme dhe jo për mallra të zakonshme apo të konsumit.

Theksojmë se materiali i brendshëm i çisternës si dhe sistemet e valvulave dhe të ventilimit të saj janë të ndotura dhe të papërshtatshme për transport ujë, veçanërisht për ujë që mund të përdoret në bujqësi apo si mall konsumi njerëzor.

Që një mjet i tillë të përdoret për qëllimin e kërkuar në DST, duhet që ai të rezultojë i çregjistruar nga kategoria ADR në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR), ku të deklarohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të mjetit. Në këtë rast çdo ndryshim teknik i mjetit do të duhet t'i nënshtrohej një verifikimi teknik të posaçëm (i quajtur re-inspektim) nga një subjekt i licencuar për inspektimin e mjeteve, në mënyrë që të siguronte dhe të garantonte se çisterna është pastruar dhe dekontanimuar nga çdo element i rrezikshëm, që mund të ndikojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi tek uji. Pra, përshtatshmëria e çisternës për ujë do të pasqyrohej me lëshimin e një Çertifikate të re të përshtatshmërisë teknike.

Të gjitha këto ndryshime do të duhet të pasqyrohen dhe të përditësohen tek dokumenti Leja e qarkullimit për mjetin, si dhe të gjitha ndryshimet do të duhet të reflektohen në sistemin e DPSHTRR.

Konkretisht referuar Lejes së qarkullimit për mjetin e deklaruar Autobot, nuk rezulton të jetë pasqyruar apo përditësuar asnjë ndryshim në lidhje me origjinën e përdorimit të tij, pasi në pikën [J.1]-Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton i deklaruar "Për Transport Mallrash të Rrezikshme".

Për sa më lart, OE "ASI INVEST" shpk, nuk plotëson kërkesën e parashikuar në Dokumentet Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5, pasi referuar dokumentacionit provues rezulton se, mjeti i deklaruar me targa AA 687 DR është Autobot për transport mallrash të rrezikshme, dhe nuk është Autobot uji ashtu siç AK ka përcaktuar në DST, përdorimi i të cilit në zbatimin e marrëveshjes kuadër me objekt: "Kryerje

e shërbimit të Gjelbërimit në SUT" për një periudhë 36 mujore", jo vetëm që do të cënonte zbatimin me cilësi dhe korrektësi të kontratës (vaditja e sipërfaqeve të gjelbërta me ujë të kontaminuar), por do të sillte edhe ndotje të ambientit duke ndikuar drejtpërdrejtë në shëndetin e pacientëve dhe qytetarëve të cilët marrin shërbim në Spitalin Universitar të Traumës.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.[...].

II.5.3.Vendimin e KSHA nr.129/2025 prot., datë 11.11.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Alb Garden" SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, protokolluar me tonën me nr.3099/3 prot., datë 12.11.2025.

III.5.4.Me shkresën nr.2811/11 prot., datë 12.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3099/4 prot., datë 14.11.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Asi Invest" SHPK pranë autoritetit kontraktor.

II.5.5. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

II.6. Në datën 31.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6030 dhe nr.3102/2025 prot, datë 31.10.2025 i operatorit ekonomik "Rej" SHPK, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Rej" SHPK , nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3102/1 prot, datë 03.11.2025.

II.6.2. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor, ka përcjellë vendimin e KSHA nr.128/2025, datë 11.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3102/2prot., datë 11.11.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "Rej" SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "Rej" SHPK.

II.6.5.Vendimin e KSHA nr.128/2025, datë 11.11.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr 2511/8 prot, datë 11.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3102/3 prot., datë 12.11.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.2811/10 prot., datë 11.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3099/2 prot., datë 12.11, ka përcjellë pranë KPP vendimin e KSHA nr.129/2025, datë 11.11.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK.

III.1.2.Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...]Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues "AlbGarden" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik "ASI INVEST" shpk me arsyen se "3. Së treti oferta e shoqërisë ASI INVEST shpk., nuk plotëson kriterin lidhur me mjetet dhe pajisjet e kërkuara. [...]nuk e përmbush kriterin e kërkuar në pikën 2.3.5 të dst lidhur me: a) mjetin për vaditjen e sipërfaqeve të gjelbërta (autobot) [...]", KSHA vëren se:.... shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori ekonomik "ASI INVEST" shpk në sistemin e prokurimit elektronik si dhe atij të dorëzuar në formë shkresore në formatin hard copy pranë Autoritetit Kontraktor, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se në përmbushje të DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5, OE nëpërmjet Shtojcës 10, Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar se disponon 1 (një) Mjet per vaditjen e sipërfaqeve të gjelbërta (Autobot) me targa AA 687 DR.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit provues, KSHA konstaton se në dokumentin e paraqitur Leje qarkullimi për mejtin me targa AA 687 DR, në pikën [J.1]-Destinacioni dhe përdorimi i mjetit,

rezulton se mjeti i deklaruar është "Për Transport Mallrash të Rrezikshme", ndërsa në pikën 4. -"Lloji i mjetit" përcaktohet "Automjet për Transport të Veçantë".

Pra, automjeti i deklaruar nga OE "ASI INVEST" shpk si mjet për vaditjen e sipërfaqeve të gjelberta (Autobot) është i rregjistruar/liçensuar dhe i destinuar për transport mallrash të rrezikshme.

Referuar Ligjit Nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme", në Nenin 4, pika 17, përkufizohet se: "Mallra të rrezikshme" janë ato substanca ose artikuj, transporti me rrugë ose me hekurudhë i të cilëve është i ndaluar ose i autorizuar vetëm në rrethana të caktuara nga ADR-ja ose RID-i".

Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar në formë shkresore hard copy pranë Autoritetit Kontraktor, KSHA vëren se automjeti me targa AA 687 DR, i deklaruar nga OE "ASI INVEST" shpk si mjet për vaditjen e sipërfaqeve të gjelberta (Autobot), është shoqëruar me stemën me numrin 33/1202. Sipas Marrëveshjes ADR rezulton se tabela 33/1202 është shenja identifikuese e rrezikut, e cila është e detyrueshme për çdo mjet që transporton mallra të rrezikshme.

Numri i pare (33) tregon shkallën e rrezikshmërisë, ndërsa numri i dytë (1203) është numri identifikues i substancës sipas Kombeve të Bashkuara (UN number), që në rastin konkret korrespondon me Benzinë (Gasolinë, Petrol) sipas listës zyrtare të mallrave të rrezikshme në ADR dhe rekomandimet e UN.

KSHA gjykon se, një mjet, i cili në Leje qarkullimi rezulton çisternë për karburant nuk mund të përdoret për transport uji për vaditje, pasi ai është projektuar në origjinë për transport substancash të rrezikshme dhe jo për mallra të zakonshme apo të konsumit.

Theksojmë se materiali i brendshëm i çisternës si dhe sistemet e valvulave dhe të ventilimit të saj janë të ndotura dhe të papërshtatshme për transport ujë, veçanërisht për ujë që mund të përdoret në bujqësi apo si mall konsumi njerëzor.

Që një mjet i tillë të përdoret për qëllimin e kërkuar në DST, duhet që ai të rezultojë i çregjistruar nga kategoria ADR në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR), ku të deklarohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të mjetit. Në këtë rast çdo ndryshim teknik i mjetit do të duhet t'i nënshtrohej një verifikimi teknik të posaçëm (i quajtur re-inspektim) nga një subjekt i licencuar për inspektimin e mjeteve, në mënyrë që të siguronte dhe të garantonte se çisterna është pastruar dhe dekontanimuar nga çdo element i rrezikshëm, që mund të ndikojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi tek uji. Pra, përshtatshmëria e çisternës për ujë do të pasqyrohet me lëshimin e një Çertifikate të re të përshtatshmërisë teknike.

Të gjitha këto ndryshime do të duhet të pasqyrohen dhe të përditësohen tek dokumenti Leja e qarkullimit për mjetin, si dhe të gjitha ndryshimet do të duhet të reflektohen në sistemin e DPSHTRR.

Konkretisht referuar Lejes së qarkullimit për mjetin e deklaruar Autobot, nuk rezulton të jetë pasqyruar apo përditësuar asnjë ndryshim në lidhje me origjinën e përdorimit të tij, pasi në pikën [J.1]-Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton i deklaruar "Për Transport Mallrash të Rrezikshme".

Për sa më lart, OE "ASI INVEST" shpk, nuk plotëson kërkesën e parashikuar në Dokumentet Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5, pasi referuar dokumentacionit provues rezulton se, mjeti i deklaruar me targa AA 687 DR është Autobot për transport mallrash të rrezikshme, dhe nuk është Autobot uji ashtu siç AK ka përcaktuar në DST, përdorimi i të cilit në zbatimin e marrëveshjes kuadër me objekt: "Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT" për një periudhë 36 mujore", jo vetëm që do të cënonte zbatimin me cilësi dhe korrektësi të kontratës (vadtja e sipërfaqeve të gjelbërta me ujë të kontaminuar), por do të sillte edhe ndotje të ambientit duke ndikuar drejtpërdrejtë në shëndetin e pacientëve dhe qytetarëve të cilët marrin shërbim në Spitalin Universitar të Traumës.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimes qëndron.[...].

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

Në kushtet kur nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 3099/2025 prot., datë 31.10.2025, të operatorit ekonomik “Alb Garden” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mos i marrë në shqyrtim, përsa kohë gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK, referuar arsytimit të bërë në këtë vendim (sipas vendimit të KSHA) do të ndryshojë nga “e kualifikuar” në “e skualifikuar”, duke përmbushur kështu interesin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: [...] *Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriterin 2.3.1. të kapacitetit teknik* [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Ndërsa në shtojcën 7 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për SUT, për 36 muaj”.

Tabela Nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia 12 muaj	Frekuenca per 36 muaj	Sasia 36 muaj
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	m2	9,000	1095	27,000
2	Kositje bari dhe largimi i tyre	m2	9,000	36	27,000
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta	m2	9,000	369	27,000
4	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)	m2	1,000	12	3,000
5	Mirembajtje pemesh dhe shkurresh	copë	900	36	2,700
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre	ml	180	15	540
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale	m2	100	6	300
8	Furnizim vendosje stolash te rinj	copë	10	3	30
9	Mirëmbajtje stolash ne ambjentet e jashtme	copë	20	3	60
10	Furnizim vendosje kosha duhani	copë	5	3	15

III.3.2.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se peratori ekonomik “Rej” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

1. Kontratë shërbimi datë 03.01.2024, lidhur mes “Rej Energy” SHPK, (porositësi) dhe “Rej” SHPK (kontraktori) me object “*Kontratë shërbimi për punime mirëmbajtje rrugore për HEC Cemerica 1,2,3*”.
- Faturë tatimore nr.158/2024, datë 13.11.2024 lëshuar nga Rej shpk për Rej Energy shpk, me përshkrimin “*Situacion mirëmbajtje rrugore në rrugët e AKS HEC Cermenica 1, 2, 3*”, me vlerë totale xxx lekë pa tvsh.
- Formular vlerësimi lëshuar nga “Rej Energy” SHPK për përmbushjem me sukses të kontratës nga “Rej”SHPK.

2. Kontratë shërbimi nr. 9, datë 22.02.2022 mes Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Rej shpk me objekt *“Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë”*, bashkëlidhur faturat tatimore për shërbimin e realizuar.
3. Kontratë punë publike nr. 3688/16 prot., datë 14.11.2022 mes Bashkisë Pogradec dhe Rej SHPK, me objekt: Rikostruksion dhe shtesë shkolla e mesme *“14 Engjejt”* dhe 9 vjecare *“Servet Agolli”* Bucimas”, me vlerë totale xxx lekë pa tvsh , bashkëlidhur faturat tatimore për punën e kryer, situacioni përfundimtar.
4. Kontratë punë publike nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023 mes Bashkisë Pogradec dhe Rej SHPK, me objekt: Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore”, me vlerë totale xxx lekë pa tvsh , bashkëlidhur faturat tatimore për punën e kryer, situacioni përfundimtar.
5. Vërtetim nr. 1048/1 prot., datë 28.04.2025 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me object *“Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njërive administrative”* nga Rej” SHPK .

III.3.3. Neni 77 *“Kërkesat për kualifikim”*, të ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”*, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.3.4. Neni 41 *“Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”*, në pikën 2 dhe 3, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

3. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të*

madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

III.3.5. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje 34 me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor, në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.1, sipas të cilit operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit. Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e përmendur në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni

konstaton se, nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), oferta e operatorit ekonomik ankimues Rej” SHPK është refuzuar me arsyetimin se zërat e shërbimeve në kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk janë të ngjashëm me asnjë nga zërat e kërkuara në specifikimet teknike, në procedurën e prokurimit me objekt “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit të SUT “. Lidhur me këtë vlerësim të bërë nga KVO, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një vlerësim i tillë nuk është i drejtë. Nga shqyrtimi i kontratave të shërbimeve të kryera nga ankimuesi, të paraqitura në SPE, si për kontratën me objekt “*Kontratë shërbimi për punime mirëmbajtje rrugore për HEC Cemerica 1,2,3*”, ashtu edhe për kontratën me objekt “*Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë*”, rezulton se ka zëra të ngjashëm me zërat e kërkuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi, e më konkretisht zëri “pastrim i vegjetacionit”.

Sa më sipër, KPP vlerëson se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka marrë në konsideratë zërat e shërbimeve me natyrë të ngjashme të paraqitura në kontratat e realizuara nga operatori ekonomik ankimues. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, dhe secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në përputhje me kriterin 2.3.1 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit të SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK, duke e skualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA nr.129/2025, datë 11.11.2025.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK dhe operatori ekonomik ‘Rej’ SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

